

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Korrik, 2018

Tiranë, më 23 Gusht 2018: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Korrik 2018 është 1.584.604. Krahasuar me Korrik 2017, ky tregues rezulton me rritje 12,3 %.


Në Korrik 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 1.028.182. Krahasuar me Korrik 2017, ky numër është rritur me 19,0 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në shtatëmujorin e 2018 është 2.947.686, duke u rritur me 12,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në Korrik 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe me 38,8 %, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Anglia me 20,9 %.

Në shtatëmujorin e 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe me 33,0 % .

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi gjatë muajit Korrik 2018 janë 1.435.804, duke shënuar një rritje me 5,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Korrik 2018 është 465.626. Krahasuar me Korrik 2017, ky numër është ulur 6,2 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Korrik 2018 është 970.178. Krahasuar me Korrik 2017, ky numër është rritur 12,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë, në shtatëmuorin e 2018 është 2.861.943, duke u rritur me 3,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Korrik-17	Korrik- 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Korrik 17	Janar- Korrik 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje gjithsej	1.379.302	1.548.604	12,3	5.199.145	5.738.166	10,4
Shqiptarë	515.279	520.422	1,0	2.575.828	2.790.480	8,3
Të Huaj	864.023	1.028.182	19,0	2.623.317	2.947.686	12,4
Dalje gjithsej	1.362.491	1.435.804	5,4	5.363.918	5.797.265	8,1
Shqiptarë	496.163	465.626	-6,2	2.759.744	2.861.943	3,7
Të Huaj	866.328	970.178	12,0	2.604.174	2.935.322	12,7

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Korrik -17	Korrik -18	Ndryshim vjrtor (%)	Janar- Korrik 17	Janar- Korrik 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	297.040	345.368	16,3	865.816	911.631	5,3
Maqedoni	95.182	97.009	1,9	341.706	381.767	11,7
Greqi	45.721	54.594	19,4	245.906	275.738	12,1
Itali	51.016	60.718	19,0	182.017	200.420	10,1
Angli	27.725	21.942	-20,9	70.626	65.316	-7,5
Mali i zi	21.956	25.011	13,9	194.039	203.206	4,7
Poloni	31.202	43.302	38,8	58.710	78.077	33,0
SHBA	21.958	23.755	8,2	57.843	64.703	11,9
Gjermani	21.809	25.560	17,2	62.889	74.261	18,1
Zvicër	18.784	18.850	0,4	33.349	32.728	-1,9
Të tjera	231.630	312.073	34,7	510.416	659.839	29,3
Gjithsej	864.023	1.028.182	19,0	2.623.317	2.947.686	12,4

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Korrik -17	Korrik-18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Korrik 17	Janar- Korrik 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrije Shtetas të Huaj	864.023	1.028.182	19,0	2.623.317	2.947.686	12,4
I. Personale	856.707	1.020.381	19,1	2.583.887	2.899.794	12,2
1. Pushime	487.275	616.954	26,6	1.049.242	1.183.022	12,8
2. Vizitë në miq e të afërm	2.605	2.854	9,6	7.897	9.378	18,8
3. Vizitë ditore	105.345	155.933	48,0	144.562	223.675	54,7
4. Trajtim shëndetësor	10	19	90,0	269	143	-46,8
5. Qëllime fetare	126	111	-11,9	427	515	20,6
6. Vizitorë të tjerë	230.427	210.172	-8,8	1.273.864	1.369.878	7,5
7. Udhëtarë transit	30.919	34.338	11,1	107.626	113.183	5,2
II. Biznes dhe profesionale	7.316	7.801	6,6	39.430	47.892	21,5

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrije gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Korrik 2017	163.863	153.871	1.061.568	127.260	88.269	1.146.962
Korrik 2018	190.807	152.042	1.205.755	155.173	89.654	1.190.977
Ndryshimi vjetor (%)	16,4	-1,2	13,6	21,9	1,6	3,8
Janar-Korrik 2017	726.065	383.412	4.089.668	692.174	349.248	4.322.496
Janar-Korrik 2018	834.805	380.069	4.523.292	785.755	330.074	4.681.436
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	15,0	-0,9	10,6	13,5	-5,5	8,3

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimit në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>